



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Komuna e Prishtinës
Pristina Obstina-Municipality of Pristina



SEKTORI I PROKURIMIT - KABINETI I KRYETARIT

Bazuar në nenin 108/A paragrafi 10 nënparagrafi 10.2 të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik lidhur me nenin 60 të Ligjit nr. 05/L-068 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin nr. 04/L-237 dhe me ligjin nr. 05/L-092, si dhe duke u bazuar në nenin 61.3. lidhur me nenin 62 paragrafi 62.1 nënparagrafi d) si dhe nenin 63 paragrafi 63.1 nënparagrafi 63.1.1 të Rregullores (A01) nr. 001/2022 për Prokurimin Publik, duke vendosur sipas kërkesës për rishqyrtim të operatorit ekonomik “Albkos Safety” Sh.P.K. të datës 17.04.2026 kundër njoftimit për kontratë dhe dosjes së tenderit lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull “83 Furnizimi, servisimi aparateve kundër zjarrit” me nr. të prokurimit 616-26-2048-1-3-6, Komuna e Prishtinës (Autoriteti Kontraktues) përmes zyrtarit përgjegjës të prokurimit nxjerr këtë:

V E N D I M

- I. **REFUZOHET** si e pabazuar kërkesa për rishqyrtim e operatorit ekonomik “Albkos Safety” Sh.P.K. të datës 17.04.2026 kundër njoftimit për kontratë dhe dosjes së tenderit lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull “83 Furnizimi, servisimi aparateve kundër zjarrit” me nr. të prokurimit 616-26-2048-1-3-6.
- II. **LEJOHET** autoriteti kontraktues që të vazhdoj me aktivitetin e prokurimit me të dhënat si në pikën I të këtij vendimi.
- III. **NJOFTOHEN** palët e interesuara lidhur me këtë vendim përmes publikimit në platformën E-Prokurimi në adresën <https://e-prokurimi.rks-gov.net>.
- IV. Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit.

Arsyetim

Operatori ekonomik “Albkos Safety” Sh.P.K. (tutje “parashtruesi”) me datë 17.04.2026 ka paraqitur kërkesë për rishqyrtim kundër njoftimit për kontratë dhe dosjes së tenderit lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: “83 Furnizimi, servisimi aparateve kundër zjarrit” me nr. të prokurimit 616-26-2048-1-3-6.

Gjatë shqyrtimit paraprak të kërkesës për rishqyrtim të parashtruesit është gjetur se kërkesa është e lejuar dhe është parashtruar brenda afatit nga personi i autorizuar si dhe nuk ekzistojnë pengesa tjera për të shqyrtuar kërkesën e parashtruesit. Në këtë mënyrë janë plotësuar kushtet për të vazhduar me shqyrtimin meritor (*in meritum*) të kërkesës.

Pretendimet e parashtruesit janë cituar si në vijim: *“Në pozicionet 8 dhe 9 është kërkuar furnizimi me aparate për fikjen e zjarrit, mirëpo në dosjen e tenderit nuk është dhënë asnjë specifikim teknik për këto pajisje. Duke qenë se legjislacioni për mbrojtje nga zjarri ndalon importin dhe vënien në përdorim të pajisjeve për shuarjen e zjarrit që nuk i përmbushin kërkesat ligjore dhe teknike, Autoriteti Kontraktues do të duhej, së paku, të kërkonte që këto pajisje të jenë të certifikuara në përputhje me standardet EN 3-7, EN 3-8 dhe EN 3-10, si dhe me CE dhe PED 2014/68/EU. Po ashtu, për të dëshmuar cilësinë dhe pajtueshmërinë e tyre, këto kërkesa do të duhej të shoqëroheshin edhe me katalogë përkatës. Gjithashtu, licenca për servisimin e aparateve dhe për testimin e hidranteve, e lëshuar nga AME, përbën detyrim ligjor dhe si e tillë duhet të kërkohej në kuadër të dokumentacionit të tenderit. Ligji kërkon (neni 28 i LPP) që specifikimet teknike të formulohen qartë në dosjen e tenderit dhe, për aq sa është e mundur, të referohen në standarde të njohura, specifikime teknike ose kërkesa funksionale. Mungesa e këtyre standardeve e bën të paqartë objektin e kontratës, e vështirëson vlerësimin e pajtueshmërisë së ofertave dhe kufizon mundësinë e operatorëve ekonomikë për të ofruar produkte ose zgjidhje ekuivalente në mënyrë të informuar dhe të barabartë”.*

Lidhur me pretendimet ankimore të parashtruesit, duhet sqaruar se AK është autoriteti i vetëm i cili ka kompetencë ligjore për të vendosur kërkesa në DT. Në rastin konkret parashtruesi kërkon që të vendosen disa kërkesa të reja. Natyrisht që vendosja e kërkesave të tilla sipas preferencave të parashtruesit është në kundërshtim me nenin 1, 6 dhe 7 të LPP. Përmes nenit 10 paragrafit 10.3 të RRPP është përcaktuar se njësia kërkuese ndër të tjera ka përgjegjësinë për të përgatitur detyrën projektuese, projektin, specifikimet teknike, termat e referencës, paramasën dhe parallogarinë. Përmes nenit 11 paragrafit 11.3 të RRPP përcaktohet se zyrtari i prokurimit ndër të tjera në bashkëpunim me njësinë kërkuese i koordinon dokumentet, projektet, specifikimet, termat e referencës, paramasat, parallogaritë dhe vizatimet. Në këtë rast zyrtari përgjegjës i prokurimit i ka falur besimin e plotë sqarimeve të ofruara nga njësia kërkuese.

Nga sa u tha më sipër është gjetur se parashtruesi nuk ka paraqitur argumente të qëndrueshme për të mbështetur pretendimet e tij. Prandaj kërkesa për rishqyrtim e parashtruesit është refuzuar si e pabazuar në tërësi. Për pikën I dhe II të këtij vendimi është vendosur duke u bazuar në nenin 63 par. 63.1.1. lidhur me nenin 62 par. 62.1. të RRPP. Për pikën III dhe IV të këtij vendimi është vendosur duke u bazuar në nenin 63 par. 63.2. të RRPP.

Bazuar në të thënat më sipër është vendosur si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

Prishtinë, 22.04.2026

Visar SHEHU

Udhëheqës i Sektorit të Prokurimit
Komuna e Prishtinës

Këshillë juridike:

Pala e pakënaqur me këtë vendim mund të paraqes ankesë pranë Organit Shqyrtues të Prokurimit brenda afatit prej dhjetë (10) ditëve pas pranimit të këtij vendimi.

Faqe 2 nga 2

Adresa: Rr. "UÇK" nr. 2, Prishtinë 10000

Tel.: 038-200-40-111

Email: visar.shehu@rks-gov.net